



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:131891

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05580876

PPP.nr.161/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit I.C.K. J.S.C, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim C.M.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit B.I.R. nga Ferizaj, rr “...”, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e debitorit, me datë 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit B.R., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.219/22, të datës 12.05.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi privat B.T. nga Ferizaj dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.219/22, i datës 12.05.2022, **PËRFUNDON** në tërësi përmbarimi në lëndën përmbarimore P.nr.219/22, si dhe **ANULOHEN** veprimet përmbarimore të ndërmarra sipas urdhrin për përmbarim P.nr.219/22, të datës 12.05.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin për përmbarim P.nr.219/22, të datës 12.05.2022, Përmbaruesi privat B.T., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori I.C.K. J.S.C, kundër debitorit B.R., për pagesën e borgjit në shumë prej 2,710.84 euro, si dhe shpenzimet e përmbarimit, në bazë të kontratës së pengut të datës, 09.06.2019, ose bllokimin e llogarive bankare të debitorit dhe sekuestrimin e kolateralit të lënë peng nga debitorit.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të refuzohet propozimi për përmbarim i kreditorit.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar, ndërsa urdhri për caktimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe gjeti se:

Prapësimi është i bazuar

Gjykata vlerëson se urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.219/22, i datës 12.05.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat B.T., nuk është i ligjshëm dhe i drejtë, nga se siç shihet nga shkresat e lëndës, marrëveshja e pengut, e datës 09.06.2019, e lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit, nuk mund të konsiderohet dokument i përmbarimit dhe nuk i plotëson kriteret dhe kushtet e kërkuara në nenin 22, par 1, nën par 1.9, të LPP-së, dhe kushtet e kërkuara nga neni 162, par 1 dhe 2 dhe 163, të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat të tjera Sendore.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se urdhri për përmbarim është marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 38, të LPP-së, Gjykata këtë pretendim e konsideron të bazuar dhe të drejtë, sepse me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës, e sidomos kontratës së pengut të datës 09.06.2019, konstatoj se kjo kontratë, e lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit Besa Ramadani, e ka humbur efektin e saj si peng pa posedim, për arsye se nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga konfirmimi i regjistrimit të pengut të datës 16.05.2022, shihet se të njëjtit i ka skaduar afati kohor me datën 16.05.2023.

Gjithashtu, Gjykata me konkluzionin e datës 18.03.2014, ka kërkuar nga kreditori që brenda afatit prej 7 ditësh, t'i sjellë vazhdimin e regjistrimit të pengut në fjalë, ku kreditori edhe pse sipas fletkthesës së kthyer nga posta e ka pranuar konkluzionin në fjalë me datën 27.03.2024, Gjykatës edhe pas kalimit të afatit prej 7 ditësh, nuk i ka sjelle vazhdimin e regjistrimit të pengut.

Për më tepër, në bazë të nenit 162, par. 1 dhe 2 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtave të tjera sendore ku thuhet se : *“regjistrimi i të drejtës së pengut pa posedim në regjistrin e pengut prodhon efekt me regjistrimin e njoftimit të pengut në zyrën për regjistrimin e pengut dhe një peng konsiderohet të jetë i regjistruar në regjistrin e pengut atëherë kur njoftimi i pengut të ketë arritur në zyrën për regjistrimin e pengut në formën e parashikuar dhe duke e paguar taksën e parashikuar”*. Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se me nenin 163, par 1 dhe 2, të Ligjit të cekur më lartë është paraparë se : *“regjistrimi në regjistrin e pengut është i vlefshëm për tri (3*

) vjet nga koha e regjistrimit. Me kalimin e afatit 3 vjeçar e drejta e pengut pa posedim e humb efektin e saj ndaj personave të tretë përveç kur vazhdohet regjistrimi ose kur pengu pa posedim është shndërruar në peng posedimor”.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, kontrata për pengun (dorëzanimin), e lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit, në bazë të cilës edhe është lejuar përmbartimi në rastin konkret, bazuar në faktin e cekur më lart, nuk i përmbush kushtet ligjore nga neni 22, par 1, nën par 1.9, të LPP-së, si dhe nga neni 162 dhe 163, të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, për tu konsideruar dokument përmbartimor, për shkak të mos vazhdimit të regjistrimit të saj në regjistrin e pengut nga kreditori.

Andaj, Gjykata duke i marrë parasysh thëniet e debitorit B.R. në prapësim, thëniet e të autorizuarit të kreditorit në përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, dhe vendosi që prapësimin e debitorit ta pranoj në tërësi si të bazuar, ta shfuqizoj urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.219/22, të datës 12.05.2022, dhe e përfundoj në tërësi përmbartimin në lëndën përmbartimore P.nr.219/22, si dhe i anuloj në tërësi veprimet përmbartimore të ndërmarra sipas urdhrit për përmbartim P.nr.219/22, të datës 12.05.2022.

Nga të cekurat më lart dhe duke u bazuar në nenin 73, par 1, 2, 3 dhe 4, të Ligjit Nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139, për Procedurën Përmbartimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.161/22, më datë 16.04.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.